



## **SHPALLJE PËR REKRUTIM EKSPERTËSH TË JASHTËM**

Autoriteti i Mediave Audiovizive në mbështetje të nenit 50, pika 3 e ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914. datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 37, neni 57 dhe neni 58, kërkon të rekrutojë 2 (dy) ekspertë të jashtëm të cilët do të përfshihen në njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave, si Anëtarë Komisioni, të procedurës së prokurimit “Shërbim Konsulence” që do të shpall institucioni ynë me objekt “Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e godinës me emërtimin *Atelier për dekorin e Radio-Televizionit* të kaluar në përgjegjësi administrimi tek Autoriteti i Mediave Audiovizive, shtesë kati dhe përshtatje për zyrat e AMA-s” si më poshtë vijon:

1. Preventivimin e kostos dhe buxhetit;
2. Hartimin e dokumentave standarte të tenderit;
3. Vlerësimin e dokumentave të tenderit;

### **TERMAT E REFERENCES**

#### **Objektivi**

Preventivimi i kostos dhe buxhetit, hartimi i dokumentave, ndjekja e procedurës së prokurimit si dhe vlerësimi i dokumentacionit që do të paraqitet nga operatorët ekonomik që do të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulence” me objekt “Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e godinës me emërtimin *Atelier për dekorin e Radio-Televizionit* të kaluar në përgjegjësi administrimi tek Autoriteti i Mediave Audiovizive, shtesë kati dhe përshtatje për zyrat e AMA-s”.

#### **Detyrat**

Ekspertët do të punojnë në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive, për realizimin e detyrave të mëposhtme:

-Me kërkesë të AMA-s dhe në bashkëpunim të ngushtë me stafin, ekspertët do të angazhohen në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 (i ndryshuar) “Për prokurimin publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914. datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

- Eksperti që do të përfshihet në njësinë e prokurimit do të paraqesë relacion profesional mbi përcaktimin e fondit limit duke pasqyruar një preventiv të kostos dhe buxhetit në të cilin do të përfshihen tarifat dhe rimbursimet dhe gjithashtu relacion profesional mbi specifikimet teknike që janë të nevojshme për këtë procedurë prokurimi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- Eksperti që do të përfshihet në komisionin e vlerësimit të ofertave do të paraqesë sugjerime dhe në bashkëpunim me stafin e AMA-s do të vlerësojë nga ana teknike dokumentat që do të paraqiten nga ana e operatorëve ekonomikë;

Autoriteti kontraktues do t'i sigurojë Eksperteve të gjithë informacionin / dokumentet e nevojshme për t'u njohur nga ekspertet me qëllim përmbushjen e detyrave të mësipërme.

**Periudha e zbatimit të detyrave:**

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë deri në përfundim të procedurës së prokurimit.

**Kualifikimet dhe aftësitë e ekspertit në Njësinë e Prokurimit:**

- Diplomë e integruar ose ekuivalenti i saj në Inxhinieri Ndërtimi / Arkitekturë;
- Eksperienca të mëparshme në formulim të detyrave të ngjashme.

**Kualifikimet dhe aftësitë e ekspertit në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave:**

- Diplomë e integruar ose ekuivalenti i saj në Arkitekturë;
- Eksperienca të mëparshme në formulim të detyrave të ngjashme.

**Produktet dhe materialet**

Eksperti do të paraqesë në gjuhën shqipe të gjitha propozimet, rekomandimet, dokumentet e hartuara në AMA.

**Raportimi**

- Eksperti pjesëmarrës në njësin e prokurimit do deponojë në AMA një relacion mbi përcaktimin e fondit limit që do përkurohet në procedurën "Shërbim Konsulence".
- Eksperti pjesëmarrës në njësin e vlerësimit të ofertave do paraqesë proces verbalët sipas legjislacionit në fuqi lidhur me plotësimin ose jo nga ana e operatorëve aplikues, të kriterëve të përcaktuara nga Institucionin lidhur me këtë procedurë.

**APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 23 TETOR 2015, ORA 14:00.**

**Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda këtij afati pranë zyrave të arshivë – protokollit pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.**

Adresa: Rruga "AbdiToptani", Tiranë